

NIKOLIN SH. LËMEZHI



U lind në fshatin Blinisht të Zadrimës më 4 shtator 1977. Mësimet e para, ato fillore dhe tetëvjeçaren i kreu në vendlindje, në shkollën “Pjetër Zarishi”, ndërsa shkollën e mesme e mbaroi në Shënkoll të Lezhës. Më pas ndjek dhe kompletton studimet e larta filozofike në Seminarin Papnor Katolik në Shkodër nga viti 1996 deri në vitin 1998. Që nga viti 1998 dhe deri nga viti 2008 ka jetuar në Itali. Në vitin 2004 përfundoi studimet e Teologjisë në Universitetin Katolik “San Tommaso” në Messina të Siçilisë.


Që në moshë të vogël pati shfaqur dëshirë e pasion për letërsinë artistike dhe jo vetëm duke lexuar libra jashtëshkollorë, por edhe duke provuar edhe vetë të vargëzojë poezi të ndryshme të frymëzuara nga natyra dhe krejt jeta në përgjithësi. Problemet dhe hallet e jetës njerëzore, ishin ato që ia tërhiqnin më shumë vëmendjen, ndaj edhe atij i ishte krijuar bindja se edhe poetët e mëdhenj, gjenitë e letërsisë, vijnë nga kushte të përvuajtura jete.

Disa nga poezitë e tij të krijuara që në shkollën tetëvjeçare, transmetoheshin nga radioja e atëhershme kombëtare dhe kjo tregon se edhe Nikolini ishte një talent i lindur në fushën e poezisë. Por krijimtaria e tij nuk kishte mbetur vetëm me kaq, pasi përgjatë viteve dhe herë pas here ka publikuar mjaft poezi, tregime, artikuj, përkthime dhe recensione tek revista katolike “Mbas Teje” dhe “Kumbona e së Diellës” si dhe në gazeta e revista të ndryshme letrare. Në tetorin e vitit 2021 publikoi librin e tij të parë, përmbëledhje poetike të titulluar “Si pika

vese” në shtëpinë botuese “Fiorentina” në Shkodër, ndërsa në muajin gusht 2022 del para lexuesit me vëllimin e dytë poetik të titulluar “Kur heshtja flet”.

Duke qenë se drejtimet e tij ideore janë kryesisht besimi në Zot dhe kryesisht në fenë e Jezusit, ai kurdoherë është gjendur në udhën e shëlbimit të shpirtit njerëzor dhe në situata të vështira ka bërë përpjekje të vazhdueshme dhe në mënyrë të palodhshme për t'u ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë, qoftë nga ana shpirtërore, qoftë edhe nga ana materiale. Kështu, në kohën e vështirë që po kalonte njerëzimi, Pandeminë Botërore të shkaktuar nga Coronavirusi Covid-19, ai ishte mjaft aktiv, sidomos duke shfrytëzuar edhe rrjetet sociale duke dhënë mesazhe shprese për njerëzit e dëshpëruar e të frikësuar.

Krahas aktivitetit të tij fetar, të cilit i ka kushtuar edhe jetën e tij, ai sot merret edhe me aktivitete të ndryshme shoqërore si me përkthime të ndryshme, por edhe me katekizëm duke ushqyer shpirtërat njerëzorë me besim dhe frymëzim Hyjnor.



Libri “**Si pika vese**” është vëllimi i parë poetik i tij të cilin e boton në vitin 2021, pasi kishte krijuar një bazë mjaft të gjerë me poezi të llojeve të ndryshme. Libri hapet me poezinë “**TË FALEM, O ZOJA E SHQIPËRISË!**” që siç duket e ka krijuar si një tekst i një kënge fetare ku në strofën e fundit ka dhënë shënimin *refren* dhe pastaj vazhdon me vargjet e tjera të strofës:

*“Të falem, o Zoja e Shqipërisë,
Pajtore e gjithë njerëzimit,
Ti burim i shpëtimit:*

Lutu, lutu sot për ne!”

Në këtë poezi, autori i drejtohet Zojës që të ketë kujdes e ta ndihmojë vendin tonë (Shqipërinë): “*Se nga gërmadhat ku qe*

zënë,/ Kokën tashmë po ngre”.

Poeti Nikolin Lëmezhi, me gjithë bindjet e tij fetare, çka duket në të gjithë përmbajtjen e kësaj poezie, shpreh edhe ndjenjat e tij atdhedashëse, pasi i drejtohet Zojës që ta ndihmojë atdheun që ishte në gërmadha dhe tash po ringjallet. Ai e do atdheun, ndaj e përshkruan me ngjyra plot dritë: “*Këtu, plot me mirësi*

Na takon e na mirëpret,

Ti zemrave u flet

Mes lulesh e dëborave.”

Pra Zoja u flet zemrave shqiptare mes lulesh e dëborave.

I ndodhur jashtë atdheut, ai shpesh shfryn përmes mjaft vergjesh e poezish malli të pashuar. Kështu vëllimi poetik “**Si pika vese**” vazhdon me dy poezi malli si “**Oh, ç’më flet ky qiell!**” dhe “**Mall**”: “*Tani larg seç je, e vogël mbesa ime dhe kushedi kur do të të shoh në sy.*

Nën qiellin blu, ndërthur mendime,

këtu zogjtë e malit më flasin për ty.

*Kështu lotët e mi, mbushur plot mallëngjim,
nga zemra burojnë dhe bien si shi.*

Kujtimi yt, oh sa më jep gëzim

e shtrenjta Jonilda, shpirti i xhaxhit ti!”

Siç shihet është një poezi me një metrikë klasike ku duket forma e organizimit të vargjeve në strofa katërshe dhe me rima të alternuara ABAB. Tek poezia tjetër ka përdorur vargun e lirë dhe të shkurtër por e mbushur me mjaft figuracion, sidomos mjaft metafora shumë të gjetura. Edhe këtu kemi organizim vargjesh në strofa pesëvargëshe: “*Oh, ç ’më flet ky qiell,/ ç ’më flasin/ këto male e fusha,/ ç ’më flet/ kjo tokë!*”

Një poezi tjetër plot frymëzim, ku autori shpreh mllef e mjerim për një epokë plot trazira që po kalon njerëzimi sot është edhe ajo me titull: **Ah jetë, o jetë!**

E di, e them haptas, një ditë do të vdes,

ndaj dhe vendosa të lë këtë shkresë.

Si robot qeshin njerëzit në këtë jetë të poshtër,
tek shohin se bota është mbushur me zotër.

Përplasat grushti tek lëviz një letër,
ngjallet vëllavrasja për një fjalë të vjetër.

Siç kalbet molla në gem, kalbëzohet jeta,
ka humbur shpirti, nxirë është ndërgjegja.

S'ka më prindër, s'ka as shok, as vëlla,
ka një xhep të zdralosur, të mbushur me para.

U prish njeriu, u përdhos çdo fe,
pa dashuri, pa familje, pa Zot, pa atdhe.

Nuk ka fytyrë, por këmbën mbi këmbë,
mjafton të ketë titullin "zotëri i rëndë".

Dhe, siç thotë fjala, vret nënë e baba,
zhelan zhelamani sot u bë pasha.

Kështu heq si kafsha për një kafshatë bukë
zhvishet nga nderi dhe hidhet në rrugë.

Na e zu frymën horllëku, si ferrë në fyt,
si SIDA që s'të falë, por vetëm të mbytë.

Vlon, vlon gjithësia në aromë të ndytë,
përpëliten krijesat dhe verbojnë nga sytë.

E...mjerisht s'ke ç'i sheh jetës pa asnjë të mirë,
se është bërë e tëra si djalli me brirë.

Dhe...nga tmerri, nga barku i boshatisur,
shëron vetëm thika, plumbi, pak helm i fëlliqur.

Ah, jetë o jetë, sa dinake je,
vret pa mëshirë e pak dhimbje s'ke!

E megjithatë faji nuk është yti,
vrasjen e bën barku i sëmurë nga fyti.

E gjersa bota një bark do të ketë,
e fëlliqur dhe në nevojë gjithmonë do të jetë.

Që në fillim, që në vargjet e para autori e shpreh haptas
keqardhjen e tij të thellë për një botë plot të këqia që e
karakterizojnë në kohën e sotme.

"...Si robot qeshin njerëzit në këtë jetë të poshtër,

tek shohin se bota është mbushur me zotër.”, ku njerëzit janë si robotë dhe jeta është e poshtë dhe bota e mbushur me zotër. Më tej vazhdon me përshkrime të tjera anësh negative që mbart bota në të cilën po jetojmë, ndaj poeti, para se t'i evidentojë ato, i vë qëllim vetes që të lërë një testament duke i atakuar ato probleme si: “Përplasat grushti tek lëviz një letër, ngjallet vëllavrasja për një fjalë të vjetër.; Siç kalbet molla në gem, kalbëzohet jeta, ka humbur shpirti, nxirë është ndërgjegja.” dhe vazhdon në një enumeracion faktesh të tjera që plotësojnë tabllonë e një bote plot trazira dhe probleme të thella shoqërore si: S’ka më prindër; s’ka as shok, as vëlla;; pa dashuri, pa familje, pa Zot, pa atdhe; si dhe enumeracioni: shëron vetëm thika, plumbi, pak helm i fëlliqur, etj.

Nga ana tjetër, botën e rënduar plot ligësi, e përshkruan edhe duke u bazuar në frezeologjinë popullore, por duke e moderuar atë. Shih si e shpreh populli: “Kur magjypi bëhet pashë, vret edhe t’anë!”; ndërsa ai e moderon në vargjet: “Dhe, siç thotë fjala, vret nënë e baba./ zhelan zhelamani sot u bë pasha.”

Poezia është e strukturuar në tetë strofa katërvargëshe me rima të përputhura AABB. Nga ana tjetër, kjo poezi, krahas mjaft enumeracioneve mjaft shprehëse, është mbështetur dhe shtrirë në një shtrat figurash të shumta letrare, sidomos krahasime, metafora dhe epiteteve metaforike. Krahasimet e bukura dhe të goditura janë: Si robot qeshin njerëzit; Siç kalbet molla në gem, kalbëzohet jeta; heq si kafsha për një kafshatë bukë; Na e zu frymën horllëku, si ferrë në fyt, si SIDA që s’thë falë, por vetëm të mbyt; si djalli me brirë; kurse metafora plot kuptim dhe peshë janë: bota është mbushur me zotër; tek lëviz një letër; ngjallet vëllavrasja; kalbëzohet jeta; ka humbur shpirti; nxirë është ndërgjegja; U prish njeriu; u përdhos çdo fe; Nuk ka fytyrë; zhvishet nga nderi; hidhet në rrugë; Na e zu frymën horllëku;

Vlon, vlon gjithësia në aromë të ndytë; shëron vetëm thika; vret pa mëshirë e pak dhimbje s'ke; vrasjen e bën barku; etj., si dhe mjaft epitete metaforike si: jetë *të poshtër*; një fjalë *të vjetër*; ka një xhep *të zdralosur*; *të mbushur* me para; “zotëri *i rëndë*”; në aromë *të ndytë*; nga barku *i boshatisur*; pak helm *i fëlliqur*; barku *i sëmurë*; *e fëlliqur*; etj.

Si mjaft poetë të ndryshëm, edhe Nikolin Sh. Lëmezhi provon të shkruajë e të paraqesë edhe poezinë ornamentale. Duke qenë klerik i fesë së krishterë dhe katolik, ai provon të shkruajë poezinë Kryq dhe ia ka arritur me poezinë e mëposhtme:

Ti, o Njeri...

Ti o Njeri
dhimbjeje,
Njeri qielli
ku shikon

mëshirshëm me këta sytë e tu hyjnorë sot
kur kryqat çdo ditë e çdo çast seç shtohen
me të Kryqëzuar dhe kryqëzues mizorisht

në format,
në vendet,
ku mendja
djallëzisht
arsyeton?
Mos vallë
Ti s'ke zë,
o jemi ne
indiferentë
t'britmave
braktisjesh
për Pajtim
e Dashuri?

Siç shihet edhe nga forma e paraqitur, poeti me këtë poezi ka imituar formën e kryqit, të cilit i ka përkushtuar edhe jetën e tij pa asnjë lloj shpërblimi, veç të mirës Hyjnore në shërbim të

njerëzve dhe besimtarëve katolikë. Dhe, si për ta vazhduar idenë e tij si njeri i vendosur i fesë katolike, në këtë vëllim poetik i ka kushtuar një vend mjaft të rëndësishëm edhe aktit sublim të meshtarit që dha jetën në diktaturën komuniste dhe kryqin nuk e shkeli, siç ia kërkuan në këmbim të jetës së tij. Këtë e ka shprehur mjaft bukur tek poezia “**Gjaku i një fetari**” ku mes të tjerave shprehet: I thonë: “*Shkele Kryqin!/ Do të dalë më mirë. /E kështu së shpejti,/ do të jesh i lirë.*” e pak më poshtë, në dy strofat e fundit nënvizon: “*Papritmas meshtari,/ Kryqin përqafoi./ Bam! –krisi pushka,/ në ballë e qëlloi./ Gjaku i derdhur,/ bukur në mur shkroi:/ Për Krishtin vdiqa,/ me Krishtin jetoj.*” Idetë e autorit aty dalin qartë e nga ana tjetër, ai nënvizon se simboli i Krishtërit është simbol lirie e shpëtimi e jo simbol robërimi. “*S’mendojnë të mjerët,/ bijtë e robërisë,/ se është vetë Kryqi,/ shenja e lirisë*”.

Në këtë vëllim poetik, poeti Nikolin Sh. Lëmezhi, duke qenë një klerik dhe i lidhur ngushtësisht me fenë, është e natyrshme që një vend të rëndësishëm do t’i kushtonte poezisë religjioze që e vë në shërbim të shpirtit të tij, por edhe të lexuesit për të hedhë dritën Hyjnore si balsam shërimi e prehjeje, si udhëtim paqeje e qetësie përmes misterit të fesë. Nga ana tjetër, aty nuk mungon edhe trajtimi i poezisë laike, si të thuash, i lirikës së dashurisë ndaj njeriut e kryesisht ndaj njeriut më të dashur të tij siç ishte nëna, ajo që i dhuroi jetë dhe dashuri pa kufi. Kjo lloj poezie është trajtuar aty në mjaft raste dhe në disa plane që i bashkon malli e dashuria e pakufishme ndaj saj si dhe adhurimi absolut që ai ka për figurën e saj. Kështu, aty kemi poezi si: **Ty Nënë...**; **ZANI, FJALA JOTE, NANË; Në shqip...**; **Loti yt i fundit, Nënë**, etj., që i japin një kolorit të gjallë këtij vëllimi poetik me ndjenja të fuqishme shpirtërore që burojnë nga një dashuri e fortë dhe sublime njerëzore. Kështu, tek poezia **Ty Nënë**, mes të tjerave ai thekson: *Në shpirtin tim vazhdon të djegë një zjarr,*

një zjarr i pashuar, dashurie që çmend. E në një këndvështrim tjetër, nënën e njeh si simbolin e dashurisë: Nënë, ti më dhurove dashurinë,/ Ti vërtetë je më e larta dashuri.

Ty Nënë...

Nuk të mbaj mend atëherë,
unë i sapolindur, me lotë në sy.
Vuajtjet shumë të mundonin si ferr
dhe vetë jeta fort, po të lëndonte ty.

Nënë, të njoha vetëm mirësinë
dhe buzëqeshjen që kurrë nuk njeh vjetërsi.
Nënë, ti më dhurove dashurinë,
Ti vërtetë je më e larta dashuri.

O Nënë, për rininë tënde kam mall
dhe sa herë e shqiptoj emrin tënd.
Në shpirtin tim vazhdon të djegë një zjarr,
një zjarr i pashuar, dashurie që çmend.

Oh, si s'mund të jap nga rinia ime,
si s'mund të të dhuroj pak vite jetë?!
Të t'shoh një çast, fytyrën me gëzime,
e në prehrin tënd, bashkë me ty le të vdes!

Edhe kjo poezi është strukturuar në katër strofa katërvargëshe me rimë të altëruar ABAB, por me numër rrokjesh jostruktiv, çka i jep nuanca të një vargu të lirë më shumë sesa një vargu klasik tetë, nëtë, apo dhjetërrrokësh që në dukje qëndron nën ritmikën e njërit prej këtij lloji vargu, ose mes tyre. Edhe figuracioni letrar i bollshëm dhe mjaft i përshtatur si metafora, krahasime dhe epitete të bukura, si dhe mjete stilistike të veçanta si apostrofa e shoqëruar edhe me ndonjë pasthirmë, i japin, jo vetëm shprehje të dukshme ndjenjës, por edhe kolorit e muzikalitet vargut. Kështu, në strofën e dytë vargu i parë dhe vargu i dytë fillojnë me fjalën Nënë, që përbëjnë anafora e po kështu përsëritet edhe

në vargun e parë të strofës së tretë, shoqëruar me një apostrofë. Anafora është e dukshme edhe në strofën e fundit ku në fillim të dy vargjeve të para përsëritet togfjalëshi si s'mund. Në vargun e parë anafora është paraprirë edhe me një pasthirmë që shpreh një duhmë shpirti të një dëshire të pamundur për t'u realizuar.

Gjithashtu, edhe metaforat janë mjaft të bukura dhe përdorur me mjaft efikasitet si: *Vuajtjet shumë të mundonin; jeta fort, po të lëndonte; më dhurove dashurinë; je më e larta dashuri; Në shpirtin tim vazhdon të djegë një zjarr; një zjarr i pashuar, dashurie që çmend*, si dhe krahasimin: *të mundonin si ferr*. Epitete të bukura janë: *i sapolindur; më e larta dashuri*, që shoqërohet edhe me një anversë (mbiemri del para emrit); *më e larta dashuri*.

Tek poezia **ZANI, FJALA JOTE, NANË**, një poezi që na kujton poezitë e rilindasve tanë si Mjeda e Fishta me poezitë e tyre përkatësisht “I tretuni” dhe “I dbuemi”, edhe poeti Nikolin Lëmezhi, në kohën që po udhëtonte drejt Bosnjes i drejtohet nënës së tij me një pasthirmë lamtumire: *Mirupafshim, nanë!* Të cilën e përsërit në fillim të dy strofave të para të kësaj poezie me tri strofa katërvargëshe, duke kërkuar kështu edhe bekimin e saj. Po kështu, një farë anafore krijojnë edhe vargu i katërt i strofës së dytë me vargun e parë të strofës së tretë ku në fillim të secilit prej tyre përsëritet shprehja “*Ti kjosh bekue...*” si një urim i shumëdëshiruëm i birit prej nënës së tij.

Tek poezia **Në shqip...**, përveç dashurisë dhe adhurimit të pakufishëm që ka për nënën, ai shpreh edhe mallin e zjarrtë që ka dhe se si ndjehet kur e dëgjon zërin e saj që i flet në shqip nëpërmjet telefonit. Sigurisht, nëna në shqip do t'i fliste, por ai çast i veçantë ishte i magjishëm për të, se, i ndodhur larg në dhé të huaj ku i mungonte fjala shqip, por sidomos edhe zëri i asaj që ia kishte mëkuar atë fjalë së bashku me qumshtin e gjirit, për të ishte gjëja më e shenjtë dhe më e dëshiruara në ato çaste

vetmie të madhe mbas pritjesh të gjata. Në strofën e fundit, si një konkluzion e një ndjenje të fuqishme, konkludon:

*Ah, ç'mbramje e bukur
n'at'orë hyjnore,
kur zani i nanës ambël m'flladiti,
po, po, zani i nanës,
në shqip... në shqip...*

Poezia **Loti yt i fundit, Nënë** na paraqet një tablo tjetër, pasi aty ai na jep momentet e ndarjes nga jeta të nënës së tij përmes pesë strofave me nga katër vargje secila me rima të alternuara pak a shumë, pasi më të dukshme si rima dalin gjithnjë vargjet e dyta dhe të katërta, ndërsa vargu i parë me të tretin jo gjithmonë rimojnë saktë. Karakteristikë të veçantë kjo poezi ka sidomos, përsëritjen e vargut të parë në secilën strofë: *Loti yt i fundit, Nënë*, që mund ta quajm edhe një përdorim anafore.

Loti yt i fundit, Nënë, seç shkëlqeu në ty si diell. Me një fjalë të pathënë, fluturove drejt në Qiell.	Loti yt i fundit, Nënë, ra në heshtje pa asnjë fjalë. Brenda tij gjithë jeta jote, amaneti për çdo djalë.
Loti yt i fundit, Nënë, si kristal ai u bë në ty. Pasi ne, edhe një herë, u shikuam bashkë të dy.	Loti yt i fundit, Nënë, e gjithë bota le ta dijë. Ra nga syri yt i shenjtë, si nga zjarri një shkëndijë.

Loti yt i fundit, Nënë,
si bekim është mbi këtë dhe.
Ndaj njëzëri po thërrasim:
Lutu Ti, o Nënë për ne!

Krahas temave të tjera që citova më lart, atë religjioze si dhe malli e dashuria për njerëzit e sidomos për nënën e tij, në këtë vëllim poetik, poeti ka kapur e trajtuar edhe mjaft tema të tjera të cilat mendoj t'i paraqes këtu disa prej tyre të shoqëruara edhe

me shembuj konkretë. Një ndër to është edhe tema shoqërore të cilën e shtrin në disa plane. Atë e shqetësojnë shumë problemet e kohës që shfaqen aty-këtu, herë në mënyrë të përgjithshme, siç ishte Pandemia Botërore, e herë në forma sporadike, apo edhe lokale në shoqërinë tonë shqiptare. Disa nga këto probleme janë paraqitur edhe tek poezia “Ah jetë, o jetë” të cilën e kam dhënë pak më sipër ku atakohen plot probleme si vëllavrasja, si edhe mjaft aspekte negative të shoqërisë së sotme shqiptare. Por këtu do të paraqes dhe komentoj disa aspekte të tjera që e shqetësojnë poetin dhe ai e shpreh revoltën dhe mllefin e tij edhe nëpërmjet vargjeve. Që kur ishte nxënës shkollë atë e shqetësonte çoroditja e arsimit shqiptar dhe sidomos anarkia që vërehej në vitet e para të demokracisë dhe e shpreh këtë tek poezia “Klasa ime” që me pak vargje i bën një skaner të plotë shkollës dhe arsimit shqip në përgjithësi:

Klasa ime

<i>Derë e zhgarravitur, tavinë e pluhurosur, banka të shkatërruara, dritare të palara,</i>	<i>nxënës të çmendur, me mësuesin në krye. Sot, ka arritur kulmi: Në shkolla mësohet çmenduria!</i>
--	---

Përmes disa epiteteve përshkruese, ai i bën një portret në karbon klasës ku ai bënte mësim, shkollës dhe arsimit në përgjithësi. Më sipër e kam paraqitur këtë poezi të shkurtër dhe kam nënvizuar epitetet përshkruese ku mes të gjithë kësaj parregullsie, nuk ka sesi të mos ketë edhe “*nxënës të çmendur, me mësuesin në krye.*” e mbi të gjitha, me një metaforë mjaft domethënëse, e përmbyll mendimin e tij: “*Sot, ka arritur kulmi:/ Në shkolla mësohet çmenduria!*”.

Me nota mjaft prekëse e ka përshkruar edhe gjendjen e mjerë e mjaft të vështirë të popullit shqiptar sidomos tek poezia **Si ëndërr**, ku mes të tjerave pasqyron një fëmijëri plot mungesa e probleme shoqërore. Këtu më poshtë po e paraqes këtë poezi pa

komente e analiza, por veç për kënaqësi të lexuesit.

SI ËNDËRR...

Si ëndërr ishte jeta, kujtoj unë atëherë. Të mbyllur dhe në terr, nga një sistem i mjerë.	Në jetën si ëndërr, kurrë nuk e harrova: «Një shoqe të klasës, për nuse e mendova».
Fëmijë këmbëzbathur, thjesht nën një çati. Zemra seç kërkonte, veç pak dashuri.	O Zot, çfarë kujtimi, sa shumë fantazi! Një botë përrallore, ajo fëmijëri.

Tashmë në jetën time,
gëzimi vërshon lumë:
Një nuse ëndërrova,
por m'u dha më shumë.

Me gjithë problemet dhe hallet e mëdha që ka atdheu, ai prapë e adhuron dhe digjet nga malli kur është larg tij. Patriotizmin e tij e ka shprehur në disa plane në disa poezi të ndryshme. Të tilla janë: **Larg...**, **Sa mall!**, **Kur rreh zemra arbnore...**, **Krenari për emrin shqiptar**, **Një komb, një gjuhë e vetme**, etj.

Tek poezia “Larg” ai ka shprehur mbi të gjitha mallin që e djeg, përmes metaforash dhe epitimesh metaforike mjaft të bukura, si dhe ndonjë krahasim. *Me zemër të copëtuar*, *Shqipëria ime e dashur* që janë epitete si dhe: *Joni dhe Tirreni ndahen*, *mendimet për ty seç përplasen*, *nata është pjellë e trishtimit*, metafora dhe *si dallgë* që është një krahasim i bukur. Gjithashtu ka përdorur edhe simplokën si mjet stilistik tek vargu i parë i strofës së parë dhe të tretë: **Larg** prej teje, **larg** që është një përsëritje e ngulitur e fjalës larg me qëllim që t'i japë forcë duhmit të mallit që ka për

atdheun e munguar.

Larg...

Larg prej teje, larg, ku Joni dhe Tirreni ndahen. Në shpirtin tim, si dallgë, mendimet për ty seç përplasen.	Me zemër të copëtuar, këtu, ku nata është pjellë e trishtimit. Mendoj si të lashë ashtu, ty, “Izrael i Perëndimit”.
---	--

Larg prej teje, larg,
kur agimi akoma s’ka zbardhur.
Të kujtoj me shumë mall,
Shqipëria ime e dashur.

Edhe kjo është një poezi e shkurtër, por mjaft konçize ku me pak fjalë shfryhet malli i poetit për vendlindjen. Është një poezi e strukturuar në tri strofa katërvargëshe me rima të alternuara të tipit ABAB. Vargu nuk ka një numër strikt rrokjesh çka e vendos këtë mes vargut metrik klasik dhe vargut të lirë. Nuk janë vargje të lira, pse janë me rima strikte, por nuk kanë numër të barabartë rrokjesh vargu me vargun.

Në poezinë **Sa mall!**, të cilën ia kushton qytetit të Shkodrës, ka përdorur mjaft anafora të shoqëruara me enumeracion faktesh malli të renditura si: *sa gjurmë kam lënë,/ sa fjalë,/ sa shikime,/ sa rrahje zemrash!*, dhe tek strofa e dytë kemi: *sa jetë kam lënë,/ sa njerëz,/ sa gëzime e dhimbje,/ sa dashuri kam lënë!*, dhe në strofën e tretë ka: *Sa jetë,/ sa njerëzim,/ sa shpirt më ka dhënë.../ Sa mall!....* por edhe në fillim të seciles strofë përsëritet i njëjti varg: *“Përtej detit,”*, si dhe: *“në rrugët e një qyteti”* në dy strofat e para, çka ngjan me një tip anafore ndërstrofike.

Një poezi plot frymëzim është edhe poezia e viteve të shkollës kur ishte nxënës në Shënkoll dhe që ua kushton arbëreshëve të Italisë duke iu referuar edhe poetit arbëresh të Rilindjes, Jeronim De Rada. Këtu më poshtë po e paraqes pa komente konkrete:

Kur rreh zemra arbnore...

*Arbëria matanë detit
na kujton se të huaj jemi te ky dhé!*

Dëgjohet përmallshëm, zë i vëllezërve tanë. Godet thellë në shpirt, kushtrim i De Radës.	Bërtet me lot' në sy: Mos pafsha diell as hënë, as qenin me zinxhirë, që jeton pa nënë!
Qan përvajshëm, zemër e copëtuar, qan arbëreshi, në dheun e huaj.	T'u laj këmbët dua, vëllezërve të mi. Se sa të jetoj, si në ferr të zi!
Vajton e bukur lule: Oh, e mjera unë! Ferrat e pamëshirshme, më luftojnë me dhunë.	Nder është për mua, të jem kështu i varfër. Pasuria ime, është emri i lartë, Arbër.
Si zambak nën hije, rritet në vetmi. Gërryhet ai në shpirt, për nënën Arbëri.	Me mall pres të vdes, të kem krahë si engjëll. Të shkoj tek nëna ime, t'jetoj në t'ngrohtën zemër.

Krenarinë e tij të ligjshme e të qenit shqiptar, poeti e shpreh që herët, që kur ishte ende në shkollën e mesme dhe për këtë na jep poezinë me tetë strofa katërvargëshe dhe pak a shumë me rima të ngulitura alternative ABAB, tek poezia: **Krenari për emrin shqiptar**, shkruar nga fillimi i vitit 1995. Që në strofën e parë, përmes krahasimeve mjaft eksklamative dhe shprehese, ai e shpreh entuziazmin e të ekzistuarit me etnicitetin shqiptar:

Lart jeton emri i shqiptarit,

si aroma e trëndafilave.

Me një gjuhë të mrekullueshme,

porsi kënga e bilbilave.

Siç shihet, emrin e shqiptarit, të qenit i tillë, e përshkruan duke e cilësuar jo vetëm të një lartësie të denjë njerëzore, por edhe për

hijeshinë që sjell: *si aroma e trëndafilav.*; *porsi kënga e bilbilave*, që janë krahasime mjaft të bukura me simbole të hijëshme nga natyra si trëndafili, apo zëri (kënga) e bilbilit. Po kështu edhe në vargjet e tjera pasuese vazhdon me një varg krahasimesh të bukura dhe mjaft shprehëse që i bëjnë një portretizim me mjaft kolorit emrit dhe të qenit shqiptar. Meqenëse krahasimet aty janë të shumta dhe të përdorura me shumë bujari e pa kursim, po i paraqes këtu më poshtë të renditura sipas radhës së përdorur aty: *Porsi deti në fortunë; Porsi ujë në burime, Si malet nën mjegull, Si kala kreshnike, Si shtrat lumi, që gërryhet, Si shqipet e maleve.*

Edhe kjo poezi është strukturuar në strofa katërvargëshe, pak a shumë me rima alternative ABAB.

Një portretizim të bukur krenarie, por edhe adhurimi e bën për shenjtoren më të re shqiptare dhe të përbotshme, Nënë Terezën, të cilën e përshkruan mjaft bukur edhe përmes antonimeve mjaft të gjetura sidomos tek vargu: “*në ballin e një gruaje të vogël-gjigande*”. Pra, një grua me trup të vogël, por gjigande nga fama e po aq e madhe edhe nga zemra e shpirti i saj human. Edhe dykuptimësia e një fjale të vetme është përdorur mjaft bukur e me zgjuarsi nga ana e autorit: *në fytyrën bujare të një gonxheje*, përshkruan autori duke e quajtur metaforikisht *gonxhe*, por duke aluduar edhe për emrin e vërtetë, emrin e pagëzimit të Nënë Terezës, Gonxhe Bojaxhiu. Pra një finesë mjaft e zgjuar dhe e bukur kjo koincidencë mes emrit konkret dhe metaforës. Po kështu ka përdorur mjaft bukur aty edhe anafora të bukura të shoqëruar edhe me apostrofa: *Ju, o rrudha shenjtërie, / Ju, o sy plot jetë, / Ju, o duar të vuajtura*, por ka përdorur edhe mjaft epitete të bukura duke i vënë në shërbim të portretizimit të asaj figure emblematike shqiptare si: *rrudha shenjtërie, fytyrën bujare, sy plot jetë, gruaje të vogël-gjigande, duar të vuajtura, jemi të braktisur, jetimë e të sëmurë, rrudha shenjtërie, sy plot jetë.*

Një tematikë tjetër e trajtuar me plot frymëzim dhe me një

kolorit plot ngjyra të ndezura janë edhe bukuritë e natyrës dhe kënaqësitë që sjell ajo, qoftë pranvera më bukuritë e saj, qoftë edhe dimri me dëborën e bardhë. Kjo është shpalosur në mjaft poezi të këtij vëllimi poetik e sidomos tek: **Ka ardhur pranvera, Si copëza Qielli..., Si Lajmëtare Paqeje..., Shtatë Liqenet e Lurës, PRANVERA**, etj.

Tek poezia **Ka ardhur pranvera**, përmes mjaft metaforave, epiteteve dhe eksklamacioneve ka përshkruar entuziazmin që e shkakton kjo stinë e bukur tek njerëzit në përgjithësi dhe tek vetë poeti në veçanti, ndërsa tek poezitë: **Si copëza Qielli...**, dhe **Si Lajmëtare Paqeje...**, ashtu siç ka ndërtuar edhe titujt e tyre, e përshkruan natyrën përmes përdorimit të krahasimeve të bukura dhe me mjaft ngjyra të ndezura kuptimore e emocionale.

Ka ardhur pranvera,

<p>Ka ardhur pranvera, oh, ç'gëzon natyra! Me barin e gjelbërt lulet ngjyra-ngjyra.</p>	<p>Qesh dielli nga lart, seç fëshfërin era. Ç'po gëzon natyra! Ka ardhur pranvera.</p>
<p>Pemët kanë çelur, bilbilat këndojnë. Ndaj bujqit ndër ara, plot hare punojnë.</p>	<p>Ka ardhur pranvera, ka ardhur për ne. Këndon sot natyra, për ty, stinë e re.</p>

Si Lajmëtare Paqeje...

<p>Kudo dëbora, e bardhë plot dëlirësi, si Lajmëtare Paqeje, zbret për çdo njeri.</p>	<p>Lozin fëmijët, gjuajnë topa bore. Gumëzhin gjithkund një jetë më gazmore.</p>
<p>Sa shumë ajo, këto ditë na ka gëzuar,</p>	<p>Na kujton dëbora, tek bie plot qetësi.</p>

me bardhësinë e saj, gjithçka e ka mbuluar.	Se zemrat janë krijuar, për dritë e pastërti.
--	--

E ndien njerëzimi,
brenda në thellësi:
Ka ardhur dëbora,
për një fillim të ri.

PRANVERA

Kanë çelur lulëkuqet, zhabinat ndër ara. Po troket pranvera, me lulet e para.	Blegërijnë delet, kecat plot gëzim, Kërcejnë të lirë, në stinën: Bekim.
Këndojnë bilbilat, dallëndyshet ndër rë. Punojnë fshatarët, tokën plot harë.	Gumëzhijnë fëmijët, si herët e tjera: Seç na iku dimri, Na çeli pranvera!

Zgjohet gjithësia,
Rilind dashuri...
Njerëzit dhe natyra,
Në një vëllazëri!

Ashtu siç e kam cilësuar edhe më sipër, në këtë vëllim poetik, një vend me mjaft hapësirë zënë sidomos poezitë me përmbajtje religjioze dhe një prej tyre është edhe poezia me titull **Fryma jote...**, në të cilën poeti shpreh adhurim për Jezusin si dashuria njerëzore e dliurë. Poeti e shpreh hapur se, jo vetëm besimi i ngulitur dhe i thelluar i tij qëndron tek Ai, por se aty gjen gjithë mbështetjen dhe strehimin e plotë shpirtëror.


Fryma jote...

Një kokë e shenjtë, e plagosur,
e varur nga dhembja e brenga.
Me plot përbuzje rrethohesh,
kurora jote bërë me gjemba.

Strehim tjetër unë nuk kam,
shpirti im i pandihmë varet te Ti:
Mos më lër vetëm, kështu siç
jam,
por mbështetmë, më jep rehati.

Tërë besimi im te Ti qëndron,
gjithë ndihma ime nga Ti më vjen.
Kokën pa mbrojtje, Ti ma mbulon
dhe hija e krahut tënd gjithnjë më
gjen.

Ngado që të endem, në rrugët plot
terr,
aty brenda meje më flet me
ngrohtësi.
Fryma jote më liron nga çdo
tmerr,
Jezus, Dashuria ime, Ti.



Libri i dytë me titull **Kur Heshtja flet**, i botuar në gusht 2022 jep mesazhe të shumta filozofike dhe është krijuar në përgjithësi mbi bazat e sentencave poetike të shkurtëra, por nuk mungojnë edhe poezi të tjera që dalin jashtë këtyre kornizave dhe kanë formate më të kompletuara si në numër vargjesh, ashtu edhe në tematika përfshirëse. Por nganjëherë, format e përmasat edhe gërshetohen mes tyre siç është poezia **Flladitje Dijeje...**, ku shprehet mendimi filozofik nëpërmjet mjaft vargjesh që nuk kanë lidhje mes tyre për nga ana organike, por janë krijuar në format e sentencave që shprehin filozofi jetësore të ndryshme. Më shumë ajo ngjan me disa frazeologjizma popullore, sesa me një poezi. Për ta pasur një koncept më të qartë po e paraqes këtu më poshtë të plotë për

lexuesin, nisur edhe nga qëllimi se ato janë sentenca me vlera të veçanta jetësore:

Flladitje Dijeje...

Nuk ha princi nga tryeza e të varfërit,
por i varfëri ha nga tepricat e princit.
Mos i jep të riut barra që s'mund t'i bartë
as përgjegjësi që i tejkalojnë forcat e tij!
Gjithsecilit jepi atë që i përshtatet
siç hidhet vera e re në rrëshiqa të rinj
dhe vera e vjetër në rrëshiqa të vjetër!
Kur të të jepet drita në mbrëmje,
mos prit mëngjesin për të vendosur për të!
Urtia që vjen prej së larti nganjëherë vishet me baltë,
por kurrë balta nuk e depërton Atë.
Edhe bukën furrtari e nxjerr nga furra
pasi të jetë pjekur,
kështu të riut mos ia vendos zgjedhën
nëse nuk ka kaluar më përpara
nëpërmjet zjarrit të përvujtërimit!
Kur fjala nuk kuptohet,
s'ka rrugë tjetër përveçse gjuhës së veprave.
Atë që njeriu me krenarinë e vet shkatërron,
Zoti me dije të shenjtë rregullon.
Për shumë një mëkat mbetet i fshehtë,
dhe për të nuk flitet sa duhet:
Ai është mëkati i lëshimit.
Kush strehohet nën hijen e të Tejetlartit,
fiton paqen e qëndrueshme.
Sa për ta konceptuar natyrën e poezisë sentencë të këtij vëllimi
poetik, po paraqesim disa prej tyre këtu më poshtë:

Gëzim në fitore...	Jetë mes rreshtash...	Derisa të ketë Dritë
---------------------------	------------------------------	-----------------------------

Nëse ka kaq gëzim në fitoret e vogla, seç gëzim do të jetë në Fitoren përfundimtare!	Jeta nganjëherë dramë është, komedi apo tragjedi, që e lexuar mes rreshtash gjithmonë është poezi.	Lundro në Hir, në këtë bekim nga Qielli e mos u tako më me botën derisa të ketë Dritë!
Parajsa, e vetmja siguri Parajsa është e vetmja siguri ku fëmijët shkojnë nga frika, të rriturit për Dashuri.	Në Dritë... Lart ka Dritë, poshtë terr, në mes më keq: Mjegull... Na ndihmo, Imzot, të qëndrojmë atje lart në Dritë!	Dashuria Dashuria nuk flet: pëshpërit; Dashuria nuk thotë: frymëzon; Dashuria nuk jep: dhuron; Ajo nuk mban për dore: shtrëngon mes krahëve.

Një poezi plot frymëzim si dhe me mjaft dëshira filozofike të autorit është edhe poezia **Ëndërroj**. Kjo poezi është ndërtuar me strukturë të veçantë ku vargjet grupohen në strofa trevargëshe ku vargu i tretë është i shkurtër, ose më saktë me një varg të dytë të thyer.

Ëndërroj

Ëndërroj të jem i pasur, t'ia ndaj mbarë pasurinë time të varfërve.	Ëndërroj të jem i dashur, të ndiej dashurinë e vëllezërve.
Ëndërroj të jem i varfër, t'u shtrij duart e mia të pasurve.	Ëndërroj të këndoj, t'u jap çlodhje njerëzve.
Ëndërroj të dua, t'u jap dashuri vëllezërve.	Ëndërroj të jem poet, të shkruaj bukuritë e jetës...

Ëndërroj drejtësinë,
që të njohim

të Vërtetën.

Një poezi me mjaft frymëzim është edhe poezia **E dua detin** me të cilën shpreh shpresën e një shërimit të një shpirti të trazuar, një shpirti të vetmuar ku shok mund t'i bëhej deti.

E dua detin...

Në duart e tua, në fytyrën tënde
dhe në sytë e tu, të gjallë, plot jetë.
Shihen vuajtjet dhe rrahjet e një zemre,
shihet braktisja e një krijese të shkretë.

Zhytur në këtë vaj, ti nuk gjen ngushëllim,
lotët t'i shton skeleti i një portreti.
Megjithëse e lodhur edhe në trishtim,
në vetmi të jetës, shok të bëhet deti.

Poshtë qiellit të vrenjtur, ku mashtrimi rreh,
pranë zhurmës së rëndë, që mendjen trazon.

Një shpresë e madhe, të ëmblin gjji të nxeh,
një shpresë, të cilën, veç deti ta dhuron.

Kjo poezi është shtrirë në një shtrat të bukur metaforash dhe epitetesh, por aty janë përdorur edhe mjete të veçanta stilistike si anasjella siç është rasti tek **të ëmblin gjji**. Metafora kemi: *Shihen vuajtjet dhe rrahjet e një zemre, shihet braktisja e një krijese, shok të bëhet deti, mashtrimi rreh, mendjen trazon, deti ta dhuron*, si dhe epitetet *të gjallë, plot jetë, krijese të shkretë, e lodhur, qiellit të vrenjtur, zhurmës së rëndë, shpresë e madhe, të ëmblin gjji*. Kjo poezi është ndërtuar me varg të rimuar me rimë alternative ABAB dhe me strofa katërvargëshe.

Kultin e heshtjes, të cilit i ka blatur edhe titullin e librit e

sjell në dy apo tri poezi filozofike, që po i jap këtu më poshtë:

Heshtja

Heshtja ka brenda

fjalë të fshehura në thellësi.

Ajo flet, po janë pak ata që e dëgjojnë,

pak janë ata që e dinë gjuhën e heshtjes.

Kush dëgjon heshtjen e fiton jetën.

Ka edhe heshtje që bëjnë zhurmë,

por Heshtja e vërtetë rrezaton paqe dhe jetë.

Pak e kuptojnë Atë, se ka një gjuhë të veçantë.

Njeriu që kupton Heshtjen, mbushet me dije.

Edhe kjo poezi është ndërtuar me varg të lirë ku përmes tyre jep disa sentenca filozofike lidhur me kultin e Heshtjes. Por diku më poshtë ka dhënë edhe sentencën filozofike për heshtjen:

Kur Heshtja flet

Kur njerëzit heshtin

dhe Heshtja flet,

aty ka Jetë.

Në këtë vëllim poetik me mjaft vlera edukative për lexuesin, nuk mungojnë edhe poezitë e mallit. Një e tillë është edhe poezia që po paraqes këtu më poshtë:

Ëndërr

Tani ti je larg, nuk je më këtu

dhe në shpirt unë e ndiej këtë bashkim.

Mrekullisht përmbi ne, është qielli blu,

me dritën e tij, si në një vegim.

Mos harro kurrë, çastin e parë

dhe dorën e hapur, që ty të dha gëzim!

Lotët mallëngjyes, nuk më janë tharë,

vajtoj në vetmi, pres me padurim.

Pres me padurim, nuk gjej qetësi
dhe çdo ditë, dy lotë, për ty i kushtoj.
Kujtohu se tashmë, unë u bëra fli
edhe pse pa ty, veç për ty jetoj...

Një poezi tjetër me mjaft vlera edukative që ka mjaft peshë filozofike, është edhe poezia **Mësim**, të cilën pa ndonjë koment të veçantë po e paraqes këtu më poshtë për lexuesin.

Mësim

Merrni mësim tek fëmijët, o njerëz!

Kur ata mësojnë të flasin,
sa herë gabojnë e gabojnë,
e ne qeshim me gabimet e tyre!

Kur mësojnë të ecin,
sa herë e sa herë rrëzohen,
e ne e dimë se ngrihen përsëri,
më të fortë se përpara.

Duke gabuar mësojnë të flasin,
duke gabuar mësojnë të ecin.

Edhe ne kështu:

Duke u rrëzuar, mësojmë...

E ç'mësim nga jeta,
për Jetën!

Gjithashtu, në këtë vëllim poetik gjenden mjaft poezi me plot frymëzim dhe me mjaft kolorit përshkrues, jo vetëm në sensin filozofik, por edhe deklarativ siç janë poezitë: **Maja e Velës**, **Fshati im**, **Vëllazëria Jeruzalemi i Ri**, **Frymëzim**, etj. Këtu më poshtë po i paraqes disa prej tyre për kënaqësi të lexuesit.

Fshati im

Oh, sa dashuri më ngjall ky fshati im!	Kujtime të bukura, nga bota e fëmijërisë.
---	--

Me ato shtëpi e zemrat plot gëzim.	Sa jetë të lumtura, në kulm të varfërisë!
---------------------------------------	--

U ndala pak çaste,
si në meditim.
Të thur pak vargje,
për ty fshati im.

Vëllazëria Jeruzalemi i Ri

Ju presim me gëzim në grupin tonë,
ku Krishti e Zoja mbretërojnë gjithmonë!
Ju presim me krahë hapur e me lumturi,
që t'ju dhurojmë paqe e shumë dashuri.

Kjo është Vëllazëria Jeruzalemi i Ri,
me vëllezër e motra plot harmoni.

Si familje e vetme këndojmë me hare:

Lavdi, Ty, o Krisht, për këtë Jetë të Re!

Ejani edhe ju në këtë ecje të bukur,
që me Engjëj e Shenjtër të jeni të lumtur!
Të lirë nga mëkati, në hir e shenjtëri,
Hyjit të Gjithëpushtetshëm t'i japim lavdi!

Frymëzim

Lumi ecën në shtratin e vet,
uji i lumit rrjedh me qetësi,
që nga burimi deri në det.
Kështu edhe jeta jonë
duhet të rrjedhë me paqe,
nga lindja deri në vdekje,
që është lindja për në Përjetësi.
Edhe unë ec përmes një rrjedhe

që quhet frymëzim...
Oh, sa i ëmbël,
qenka ky lundrim!

Maja e Velës

Ti ishe pjesë e ditëve tona,
e palëvizshme në çdo stinë.
Unë gjithmonë këtu të gjej,
o Vela e Kallmetit, ti më kujton fëmijërinë!
Të shoh edhe tani madhështore dhe të bukur,
o maja më e lartë e kësaj toke të bekuar.
Ti e heshtur në shekuj na bën gjithmonë të lumtur
e zemrat drejt qiellit me ty janë lartësuar.
Në gjirin tënd diku aty është fshehur,
Kisha e madhe e shenjtes Eufemi.
Me ujin e bekuar që buron pareshtur,
ajo çdo shtegtari seç i jep freski.
Nga fshatra, qytete e nga brigjet e detit,
me gëzim brohorasin bijtë e Shqipërisë:
Bekuar qofsh ti Vela e Kallmetit,
Lavdi ndër shekuj, o Kisha e shën 'Misë!

Si përfundim, duke i hedhur një vështrim të përgjithshëm të gjithë krijimtarisë së poetit Nikolin Shtjefen Lëmezhi, nënvizoj se natyra e përgjithshme e poezisë së tij ka më tepër karakter filozofik me drejtim religjioz dhe mjaft edukativ për lexuesin e tij. Ai merr frymëzim e jetë nga Hyji dhe Drita Hyjnore dhe shkruan vargje plot devotshmëri. Kjo është e natyrshme për vetë formimin e tij filozofik e ideor si klerik katolik dhe një misionar i përçimit të frymës Hyjnore tek besimtarët e kësaj feje së cilës edhe ia ka kushtuar të gjithë jetën e qenien e tij. Poezitë e kësaj

fryme, nuk janë thjesht poezi lutjesh apo uratësh të zakonshme, por mësimë mjaft edukative që ai ua drejton lexuesve të tij. Kjo gjë duket më shumë në vëllimin e parë, ndërsa në vëllimin e dytë më shumë spikat poezia sentecë mendimi e filozofie, megjithëse këto gërshetohen edhe nga njëri libër tek tjetri.

Poeti, sidomos në vëllimin e parë, gamën e krijimtarisë së tij poetike e ka shtrirë edhe në fusha të tjera, përveç drejtimit fetar. Aty ai ka trajtuar mjaft bukur motivet patriotike si dhe mallin e dashurinë për njerëzit. Ai ndjehet krenar për emrin shqiptar dhe e përlligj krenarinë e tij duke sjellë mjaft fakte lavdie të cilat i përkasin kombit shqiptar dhe, i frymëzuar prej tyre, thur vargje me mjaft frymëzim poetik.

Kur përshkruan natyrën, vargu i tij sjell tek lexuesi aromën e këndshme të trëndafilave dhe zërin e ëmbël e shungullues të bilbilave në blerim të prillit, cicërimat e dallëndysheve, kecat që lodrojnë plot gaz e hare, blegërimat e qingjave e mbi të gjitha gumëzhitjet plot hare të fëmijëve e dielli buzëqesh nga lart dhe era fëshfërin lehtas. Aty sjell bardhësinë e ndritshme dhe të dliirë të dëborës që sjell freski e gjallëri në shpirtin e poetit, por edhe tek të gjithë si lajmtare, ajo sjell paqe e mirësi. Sjell në poezinë e tij dallgët joshëse të detrave që të bëjnë shoqëri shërimi në çaste të një vetmie vrastare. Vela, nga ana tjetër, që i rri nuses Zadrimë si një kurorë mbi ballë dhe që lartohet plot madhështi e krenari, i sjell frymëzim poetit edhe për faktin se në zemër të saj ka mirësi e shenjtëri, pse aty është Shën Eufemia që: *Me ujin e bekuar që buron pareshtur,/ ajo çdo shtegtari seç i jep freski.*, thekson ai. Po edhe fshati i tij i sjell kujtime të pashlyeshme dhe frymëzohet prej tyre. Me gjithë hallet dhe problemet që ka pasur ai në kohën e së shkuarës, në fëmijërinë e tij, përsëri i sjell mall, nostalgji e dashuri pa fund, por edhe frymëzim të fuqishëm poetik.

Nga ana strukturore, ai vargëzon si zakonisht me varg të lirë, por shpesh i drejtohet vargëzimit klasik me organizim poezie të

strukturuar në strofa të rregullta ku më së shumti parapëlqen atë me katër vargje dhe me rima të ngulitura, herë alternative e herë të përputhura, por pa e vrarë mendjen tek metrika e vargut me numër rrokjesh të fiksuar. Gjithashtu, ai noton bukur e lirshëm mbi një shtrat të bollshëm me figura e gjetje mjetësh stilistike që i japin vlerë dhe kuptim poezisë së tij. Nga ana tjetër, ai provon dhe eksperimenton edhe forma të ndryshme vargëzimi, si dhe paraqitje poezie ornament duke imituar në formë edhe simbole karakteristike të ndryshme.

Tom Gjokhilaj, Londër, dhjetor 2022.